

## Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë MISIONI NË KOSOVË

### Raporti 06/2006 i Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës 5 gusht 2006 – 13 tetor 2006

#### Titujt kryesor

- Kuvendi debaton mbi raportin e Grupit të Unitetit lidhur me procesin për zgjidhjen e statusit
- Kuvendi e hedh poshtë rekomandimin e Panelit Special lidhur me Ligjin për përdorimin e gjuhëve, por e anulon vendimin në seancën e radhës
- Kuvendi miraton një deklaratë me të cilën dënon incidentet e fundit të sigurisë në Kosovë
- Kryeministri përgjigjet në interpelancën e PDK-së lidhur me letrën e kryesisë së LDK-së
- Kuvendi miraton Ligjin për trashëgiminë kulturore

#### 1. Sfond

Raporti i dyzetetë i monitorimit është hartuar në përputhje me pikëpamjet referuese të Shtyllës së III-të të UNMIK-ut për themelimin e institucioneve (OSBE) dhe monitorimin e Kuvendit të Kosovës prej 26 nëntor 2002 dhe bazohet në pajtueshmërinë me Rregulloren e re të punës të miratuar në fund të seancës plenare më 20 maj 2005, dhe të amandamentuar në seancën plenare të mbajtur më 1-2 qershor 2006.

Gjatë periudhës raportuese, Kuvendi ka mbajtur pesë seanca plenare, më 31 gusht, 1 dhe 6 shtator, 14 shtator, 21 shtator dhe 9-10 tetor, si dhe katër mbledhje të Kryesisë, më 28 gusht, 11 shtator, 14 shtator dhe 3 tetor. Të dhjetë komisionet, si dhe nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, peticione dhe ankesa publike, i kanë mbajtur mbledhjet gjatë kësaj periudhe.<sup>1</sup> Shtylla e III-të (OSBE) i ka monitoruar seancat plenare dhe mbledhjet e Kryesisë, si dhe 18 prej 39 mbledhje të komisioneve dhe një dëgjim publik.<sup>2</sup>

<sup>1</sup> Komisioni për çështje gjyqësore, legjislativ dhe Kornizë Kushtetuese është takuar më 4, 8 dhe 20 shtator dhe 2 tetor, derisa Komisioni për shërbime publike, administratë lokale dhe media është takuar më 12 dhe 19 shtator dhe 12 tetor. Komisioni për buxhet dhe financa është takuar më 11, 19 dhe 26 shtator dhe 4 tetor, derisa Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve është takuar më 11, 18 dhe 28 shtator. Komisioni për shëndetësi, punë, mirëqenie sociale dhe persona të zhdukur është takuar më 29 gusht, 5, 12, 19 dhe 29 shtator dhe 3 tetor, derisa Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport është takuar më 7 shtator. Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integrimet Euro-Atlantike është takuar më 22 shtator, derisa Komisioni për gatishmëri emergjente është takuar më 30 gusht dhe 13 shtator. Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor është takuar më 5, 12, 19 dhe 26 shtator dhe 11 tetor, derisa Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion është takuar më 28 dhe 29 gusht, 5, 12, 19 dhe 20 shtator, dhe 3, 11 dhe 12 tetor. Nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, ankesa dhe parashpresa publike është takuar më 7 dhe 28 shtator. Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor ka mbajtur dëgjimin publik të projektligjit për parqet nacionale më 3 tetor.

<sup>2</sup> Komisionin për buxhet dhe financa më 11 dhe 19 shtator; Komisionin për të drejtat dhe interesat e komuniteteve më 11, 18 dhe 28 shtator. Komisionin për çështje gjyqësore, legjislativ dhe Kornizë Kushtetuese më 4, 8 dhe 20 shtator dhe 2 tetor; Komisionin për shërbime publike, administratë lokale dhe media më 19 shtator; Komisionin për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integrimet Euro-Atlantike më 22 shtator; Komisionin për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor më 5 dhe 12 shtator; Komisionin për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion më 29 gusht, 19 dhe 20 shtator dhe 11 dhe 12 tetor; dhe dëgjimin publik të projektligjit për parqet nacionale më 3 tetor

## 2. Vështrim

**Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 31 gusht** e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Mahir Yagcilar (6+/KDTP).

- Nëntëdhjetë e pesë deputetë ishin të pranishëm në seancë plenare më 31 gusht.<sup>3</sup>
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 31 gushtit:
  - Pyetjet për Qeverinë
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për adaptimin e Konventës së Këshillit të Evropës mbi krimin në fushën e kibernetikës  
(Projektligji është miratuar në parim me 54 vota për dhe pa vota kundër.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për kontrollimin e cilësisë së produkteve të caktuara për import dhe eksport  
(Kjo pikë është hequr nga rendi i ditës. Shiko paragrafin e titulluar “Rendi i ditës”.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për amendamentimin e Ligjit 2004/08 për energjinë  
(Projektligji është miratuar në parim me 66 vota për dhe tetë vota kundër.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për amendamentimin e Ligjit 2004/09 për rregullatorin e energjisë  
(Projektligji është miratuar në parim me 46 vota për dhe 24 vota kundër.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për mbrojtjen e bimëve  
(Projektligji është miratuar në parim me 63 vota për dhe dy vota kundër.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për mbrojtjen e varieteteve të bimëve  
(Projektligji është miratuar në parim me 64 vota për dhe dy vota kundër.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për amendamentimin e Ligjit 2003/25 për kadastrin  
(Projektligji është miratuar në parim me 70 vota për dhe dy vota kundër.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për shpronësimin  
(Projektligji është miratuar në parim me 60 vota për dhe 15 vota kundër.)

**Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 1 dhe 6 shtator** e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Gazmend Muhaxheri (ORA).

- Tetëdhjetë e tre dhe 77 deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 1, përkatësisht 6 shtatorit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 1 dhe 6 shtatorit:
  - Debati mbi raportin e Grupit të Unitetit lidhur me procesin për zgjidhjen e statusit  
(Të gjithë anëtarët e Grupit të Unitetit kanë bërë paraqitjet e tyre, pas së cilave ka pasuar debati dhe deklaratat përfundimtare të anëtarëve të Grupit të Unitetit.)

**Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 14 shtator** e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Xhavit Haliti (PDK).

- Tetëdhjetë e katër deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 14 shtatorit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 14 shtatorit:
  - Shqyrtimi i raportit të punës të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit (ART) për vitin 2005  
(Kjo pikë e rendit të ditës është shtyrë Shiko paragrafin e titulluar “Rendi i ditës”.)
  - Shqyrtimi i raportit të Komisionit për gatishmëri emergjente lidhur me marrjen e kompetencave për mbikëqyrjen parlamentare në fushën e sigurisë

<sup>3</sup> Kjo është shifra e dhënë nga Kryetari i Kuvendit në fillim të seancës, përveç nëse në këtë raport është bërë e ditur në ndonjë mënyrë tjetër.

(Z. Naim Maloku (AAK), kryesues i komisionit, ka bërë paraqitjen e raportit që është përcjellur me deklaratat e bëra në emër të grupeve parlamentare dhe miratimi i riemërimit të Komisionit në Komisionin për siguri.<sup>4</sup>)

- Shqyrtimi i rekomandimit të Panelit Special lidhur me mocionin e grupit 6+ me të cilin kundërshtohet Ligji për përdorimin e gjuhëve (Kuvendi e ka hedhur poshtë rekomandimin me 41 vota për dhe 48 vota kundër.)
- Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për çështje gjyqësore, legislative dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve (Kjo pikë është shtyrë. Shiko paragrafin e titulluar “Rendi i ditës”.)

**Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 21 shtator** e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Naim Maloku (AAK).

- Nëntëdhjetë e pesë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 21 shtatorit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 21 shtatorit:
  - Interpelanca e PDK-së për Kryeministrin lidhur me letrën e Kryesisë së LDK-së (Shiko paragrafin e titulluar “Interpelanca”.)
  - Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për çështje gjyqësore, legislative dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve (Rekomandimet e Komisionit janë miratuar me 42 vota për dhe 26 vota kundër.)

**Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 9-10 tetor** e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Sabri Hamiti (LDK).

- Shtatëdhjetë e katër dhe 73 deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 9, përkatësisht 10 tetorit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 9-10 tetorit:
  - Pyetjet për Qeverinë
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për amandamentimin e Ligjit 2003/17 për prokurimin publik (Projektligji është miratuar në parim me 49 vota për dhe 16 vota kundër.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për amandamentimin e Ligjit 2004/49 për patentim (Projektligji është miratuar në parim me 56 vota për dhe tri vota kundër.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për transfuzionin e gjakut (Projektligji është miratuar në parim me 65 vota për dhe katër vota kundër.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për mbrojtjen nga zhurma (Projektligji është miratuar në parim me 61 vota për dhe një votë kundër.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për pajisjet nën presion (Projektligji është miratuar në parim me 64 vota për dhe pa vota kundër.)
  - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për trashëgiminë kulturore (Projektligji është miratuar me 56 vota për dhe 14 vota kundër.)
  - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për kërkimet gjeologjike (Projektligji është miratuar me 52 vota për dhe 19 vota kundër.)
  - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për shëndetin riprodhues (Projektligji është miratuar me 67 vota për dhe pa vota kundër.)
  - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për peshkatarin dhe akuakulturën (Projektligji është miratuar me 70 vota për dhe pa vota kundër.)
  - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për amandamentimin e Ligjit 2004/5 për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës (Projektligji është miratuar me 65 vota për dhe pa vota kundër.)

---

<sup>4</sup> Shiko raportin 09/2005 të Shtyllës së III-të, përkatësisht paragrafin e titulluar “Formimi i Komisionit për siguri” për më tepër detaje.

### 3. Punimet dhe praktikat parlamentare në seancat e Kuvendit

#### Rendi i ditës

- Në fillim të seancës plenare të 31 gushtit, z. Alush Gashi (LDK) kërkoi nga Ministri për Tregti dhe Industri Bujar Dugolli (AAK) të sqarojë propozimin me shkrim të bërë nga ministri dhe komisioni parlamentar për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe komunikacion për heqjen e projektligjit për kontrollin e cilësisë së produkteve të caktuara për import dhe eksport nga rendi i ditës së seancës në fjalë. Ministri Dugolli sqaroi se propozimi ishte bërë në pajtim me komisionin funksional me arsyetimin se kjo çështje duhet të rregullohet me udhëzim administrativ dhe jo me ligj. Kryetari i Kuvendit lajmëroi se ai nuk kishte marrë asnjë propozim tjetër me shkrim për ndryshimin e rendit të ditës, andaj konkludoi se rendi i ditës konsiderohej i miratuar, përfshirë propozimin për heqjen e projektligjit në fjalë, duke mos e hedhur në votim propozimin.

Në fillim të seancës plenare të 14 shtatorit, z. Jakup Krasniqi (PDK) propozoi që pika për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtyhej për seancën e radhës duke komentuar se deputetët e kishin marrë materialin pak para fillimit të seancës në fjalë pa pasur kohë ta shqyrtojnë atë. Z. Alush Gashi (LDK) propozoi që raporti i punës i Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit (ART) të shtyhej duke komentuar se raporti nuk ishte i plotë dhe se Kuvendi duhet të kërkojë informata shtesë nga ART-ja. Kryetari i Kuvendit e ftoi Kuvendin t'i votonte një nga një propozimet e bëra nga z. Krasniqi dhe z. Gashi, të cilat janë miratuar me shumicë votash për.

Në fillim të seancës plenare të 21 shtatorit, Kryetari i Kuvendit lajmëroi se para fillimit të seancës në fjalë kishte marrë një propozim me shkrim nga grupi parlamentar 6+ për futjen në rendin e ditës të rekomandimit të Panelit Special lidhur me Ligjin për përdorimin e gjuhëve, i cili ishte refuzuar gjatë seancës së mëparshme, për rishqyrtim nga Kuvendi.<sup>5</sup> Kryetari i Kuvendit e vëri në votim propozimin në fjalë, i cili është miratuar me shumicë votash. Z. Sabri Hamiti (LDK) propozoi që Kuvendi *urgjentisht* të nxirrte një deklaratë me të cilën do t'i dënonte incidentet e fundit të sigurisë që kishin ndodhur në disa komuna të Kosovës. Kryetari i Kuvendit e vëri në votim propozimin e z. Hamiti, i cili është miratuar me shumicë votash për, dhe ftoi shefat e grupeve parlamentare që ta hartonin një tekst të deklaratës, e cila formalisht do të miratohej nga Kuvendi më vonë gjatë seancës.<sup>6</sup>

Në fillim të seancës plenare të 9 tetorit, z. Emrush Xhemajli (LPK) bëri vërejtjen që rendi i ditës i seancës në fjalë është dashur të miratohet në seancën e kaluar “siç ishte praktika më parë”, dhe njëkohësisht propozoi që si pikë e fundit e rendit të ditës së seancës në fjalë të jetë propozimi i rendit të ditës për seancën e radhës. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se dispozita për caktimin e rendit të ditës është ndryshuar më 1 qershor dhe se rregulla e re nuk kërkon që rendi i ditës të miratohet në seancën e mëparshme.

*Rregulla e re 23.1-2 parasheh që “Kryesia e përgatit një propozim të rendit të ditës për seancën e radhës së Kuvendit dhe menjëherë e vë në dispozicion për deputetët e Kuvendit. Në fillim të seancës ky propozim do të konsiderohet i miratuar, përveç nëse një ose më shumë grupe parlamentare, apo gjashtë (6) deputetë i propozojnë me shkrim Kryetarit një amendament në rendin e ditës, i cili hudhet në votim.” Andaj, propozimi i Komisionit për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe komunikacion, i parashtruar më herët me shkrim në pajtim me rregullat e reja, është dashur të hedhet në votim. Në seancën plenare të 14 shtatorit, grupi parlamentar i LDK-së dhe ai i PDK-së kanë bërë propozime gojore, sipas rregullës së*

<sup>5</sup> Për më shumë detaje, shiko më poshtë paragrafin e titulluar “Mocionet kundër ligjeve të miratuara mbi bazën e ndikimit të tyre në interesat jetike të komuniteteve.”

<sup>6</sup> Për më shumë detaje, shiko më poshtë “Deklarata për dënimin e incidenteve të sigurisë në Kosovë”.

mëparshme,<sup>7</sup> e cila nuk është më në fuqi, dhe e cila lejonte që amandamentet në rendin e ditës të propozoheshin gojarisht.

Rregulla 29.1 parasheh që “në çdo seancë plenare, deputeti në marrëveshje me Kryetarin e Kuvendit, mund të propozojë që Kuvendi të shqyrtojë menjëherë një çështje urgjente. Nëse Kryetari i Kuvendit konsideron se çështja menjëherë meriton t’i kushtohet vëmendja e Kuvendit, deputetit në fjalë i mundëson të japë propozimin në Kuvend që pastaj do ta vëjë në votim.” Andaj, ishte në të drejtën e Kryetarit të Kuvendit t’i lejojë z. Hamiti ta paraqesë propozimin e tij, si dhe të njëjtin ta vëjë në votim.

Rregullat e reja 23.1-2 kërkojnë që rendi i ditës të miratohet në fillim të seancës plenare në fjalë. Pohimi i z. Xhemajli ishte gabimisht i bazuar në rregullën e mëparshme 23.1, e cila kërkonte që rendi i ditës të miratohet nga Kuvendi në fund të seancës së mëparshme.

### Mocionet procedurale

- Komisioni për çështje gjyqësore, legislative dhe Kornizë Kushtetuese, në mbledhjen e mbajtur më 4 shtator, e ka diskutuar mocionin e parashtruar më 23 qershor nga z. Emrush Xhemajli (LPK) në të cilin pohonte se të drejtat e tij të parapara me rregullat 30.1 (b) dhe 30.2 janë shkelur në seancën plenare të 15 qershorit meqë atij i ishte lejuar të fliste vetëm një minutë dhe propozimi i tij për ndërprerjen e punimeve të seancës plenare të 15 qershorit nuk ishte vënë në votim.<sup>8</sup> Z. Husnija Beshkoviq (6+/Vakat), z. Dragisha Krstoviq (SLKM) dhe z. Nazim Jashari (ORA) pohan se kryesuesi i seancës plenare nuk i kishte shkelur të drejtat e z. Xhemajli me mosvënien në votim të propozimit të tij, me arsyetimin se z. Xhemajli nuk e kishte përkrahjen e të paktën një grupi parlamentar siç kërkohet me rregullën 30.7, por se e drejta e tij për të folur ishte shkelur. Znj. Nekibe Kelmendi (LDK) pohoi se as e drejta z. Xhemajli për të folur nuk ishte shkelur, duke komentuar se rregullorja nuk përcakton kufizim kohor për mocionet procedurale. Kryesuesi i komisionit, z. Hydajet Hyseni (PDK) konstatoi se rregullat janë të paqarta dhe kundërthënëse sa i përket votimit të mocioneve procedurale të propozuara nga deputetët individual, dhe se e drejta e fjalës e z. Xhemajli ishte shkelur. Komisioni nuk mundi të pajtohej për një rekomandim konsensual, kështu që me gjashtë vota për dhe katër vota kundër konkludoi se nuk ka pasur shkelje në mosvënien në votim të propozimit të z. Xhemajli, por se e drejta e tij e fjalës ishte shkelur nga kryesuesi në seancën plenare të 15 qershorit.

Rregulla 30.1(b) dhe 30.2 parasheh se “në çdo seancë plenare të Kuvendit, deputetit i jipet e drejta të propozojë [mocion procedural] për të . . . shtyrë seancën. Për mocionin për ta shtyrë seancën, menjëherë mbahet votim pa debat.” Në anën tjetër, rregulla 30.7, parasheh që “mocioni . . . për ta shtyrë seancën duhet të ketë mbështetjen së paku të një grupi parlamentar para se të debatohet.” Është e këshillueshme që një mospërputhje e tillë në mes të dispozitave të lartpërmendura të eliminohet në mënyrë që të ofrohet një interpretim i qartë dhe i qëndrueshëm lidhur me atë nëse mocionet procedurale të parashtruara nga deputetët individual duhet të votohen menjëherë, pa debat (30.1(b) dhe 30.2) apo duhet detyrimisht ta kenë mbështetjen e një grupi parlamentar dhe të debatohen (30.7).

Rregulla 22.7 parasheh që “diskutimi në Kuvend nuk zgjat më shumë se 10 (dhjetë) minuta për secilin deputet të Kuvendit, nëse Kuvendi nuk vendos ndryshe. Diskutimet lidhur me rendin e ditës nuk zgjasin më shumë se dy (2) minuta.” Propozimi i z. Xhemajli për ndërprerjen e punimeve të Kuvendit nuk ishte deklarata lidhur me rendin e ditës, por mocion procedural i definuar në rregullën 30.1(b) dhe 30.2. Rregullorja nuk përmend shprehimisht kufizim kohor për mocionet procedurale. Deklarata e z. Xhemajli është ndërprerë pas një minute me supozimin se ai po fliste për rendin e ditës, dhe me pohimin e gabuar se deklarata lidhur me rendin e ditës zgjasin vetëm një minutë.

<sup>7</sup> Rregulla e mëparshme 23.1 parashihte se “Në fund të çdo seance, Kryetari i Kuvendit, ose një anëtar tjetër i Kryesisë, propozon rendin e ditës të seancës së ardhshme. Ky propozim konsiderohet i miratuar, përveç në rastet kur një ose më shumë grupe parlamentare ose . . . gjashtë deputetë e kundërshtojnë këtë.”

<sup>8</sup> Për më shumë detaje, shiko raportet 04/2006 dhe 05/2006 të Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

*Rregulla 30.8 parasheh se “mocionin . . . për shkeljen e të drejtave të deputetit mund ta bëjë vetëm një deputet. Ky mocion i parashtrohet Komisionit për çështje gjyqësore, legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, që në seancën e parë plenare të Kuvendit duhet ta paraqesë rekomandimin e tij lidhur me mocionin.” Tetë seanca plenare kanë kaluar që kur z. Xhemajli e ka parashtruar mocionin e tij më 23 qershor, mirëpo rekomandimi i Komisionit për çështje gjyqësore, legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ende nuk i është paraqitur Kuvendit.*

- Në seancën plenare më 1 shtator, gjatë debatit mbi procesin e zgjidhjes së statusit, z. Jakup Krasniqi (PDK) deklaroi se ishte pajtuar me z. Alush Gashi (LDK) që debatin duhej ndërprerë dhe shtyrë për javën e ardhshme, me arsyetimin se materiali ishte shpërndarë pak para fillimit të seancës në fjalë dhe se deputetët nuk kanë pasur mjaft kohë ta shqyrtojnë atë. Në emër të grupeve të tyre parlamentare, znj. Gjylnaze Sylja (AAK), znj. Teuta Sahatqija (ORA) dhe z. Ferid Agani (PI) e mbështetën propozimin për shtyerjen e debatit për javën e ardhshme. Z. Xhezair Murati (6+/Vakat) deklaroi se grupi i tij parlamentar e mbështeste propozimin për shtyerjen e debatit për një arsye më tepër, duke pohuar se deputetët boshnjakë nuk e kishin marrë materialin në gjuhën e tyre (shiko më poshtë paragrafin e parë nën “Qasja dhe pjesëmarrja e barabartë e komuniteteve”). Kryetari i Kuvendit e hudhi në votim shtyerjen e debatit për 6 shtator, i cili është miratuar me shumicë votash për.

*Sipas rregullës 6.3, “ftesa me rend dite dhe materialet për shqyrtim u dërgohen deputetëve së paku tri ditë pune para seancës plenare.” Andaj, mocioni procedural i grupeve parlamentare për shtyerjen e debatit për t’i dhënë më shumë kohë deputetëve për ta shqyrtuar materialin dhe për të siguruar përkrahimin në të dy gjuhët zyrtare ishte në pajtim me rregulloren.*

- Më 6 shtator, në vazhdimin e seancës plenare të filluar më 1 shtator, z. Ferid Agani (PD/Partia e Drejtësisë) propozoi në emër të Grupit për Integrim që Kuvendi të fuste, si pikë urgjente, miratimin e një deklaratë lidhur me rolin e Kuvendit në procesin e zgjidhjes së statusit, në rendin e ditës të seancës në fjalë. Ai e ftoi Kryetarin e Kuvendit që propozimin e Grupit për Integrim ta hedhte në votim në pajtim me rregullën 29.2, duke shtuar se për tekstin e deklaratës mund të arrihej marrëveshje me shefat e grupeve të tjera parlamentare. Kryetari i Kuvendit nuk e hudhi në votim këtë propozim. Më 11 shtator, z. Agani i ka dorëzuar Kryesisë një mocion procedural në të cilin pohonte se në seancën plenare të 6 shtatorit është shkelur Rregullorja e punës ngase propozimi i Grupit për Integrim për miratimin e deklaratës në fjalë si pikë urgjente nuk është hedhur në votim. Në mbledhjen e saj të mbajtur më 3 tetor, Kryesia ia ka përcjellur Komisionit për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese mocionin e z. Agani.<sup>9</sup>

*Sipas rregullës 29.2 e cila parasheh që “propozimi i grupeve parlamentare për çështjet urgjente vendoset nga Kuvendi”, është dashur t’i mundësohet Kuvendit të deklarohet me anë të votimit lidhur me propozimin e Grupit për Integrim për miratimin e deklaratës.*

*Rregulla 30.1(e) parasheh që “në çdo seancë plenare të Kuvendit deputetit i jepet e drejta të propozojë [mocion procedural] për të . . . konstatuar zbatimin e Rregullores së punës.”*

*Rregulla 30.8 parasheh që “mocionin për të konstatuar zbatimin e Rregullores së punës . . . mund ta bëjë vetëm një deputet. Ky mocion i parashtrohet Komisionit për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese, që në seancën e parë plenare të Kuvendit duhet ta paraqesë rekomandimin e tij lidhur me mocionin.”*

### Shpërndarja e dokumenteve

- Projektligji për kadastrin u është shpërndarë deputetëve më 3 korrik; projektligji për adaptimin e Konventës së Këshillit të Evropës mbi krimin në fushën e kibernetikës, projektligji për kontrollin e cilësisë së produkteve të caktuara për import dhe eksport, projektligji për amendamentimin e Ligjit 2004/09 për rregullatorin e energjisë, dhe projektligji për mbrojtjen e bimëve janë shpërndarë më 28 korrik. Projektligji për shpronësimin është shpërndarë më 4 korrik ndërsa projektligji për mbrojtjen e varieteteve të bimëve është shpërndarë më 11 gusht.

<sup>9</sup> Shqyrtimi i mocionit të z. Agani nga Komisioni është bërë jashtë periudhës raportuese andaj do të mbulohet në raportin e radhës.

Andaj, projektligjet janë shpërndarë 41, 22, 17, përkatësisht dymbëdhjetë ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare më 31 gusht. Projektligji për amandamentimin e Ligjit 2003/17 për prokurimin publik, projektligji për amandamentimin e Ligjit 2004/49 për patentim dhe projektligji për transfuzionin e gjakut janë shpërndarë më 31 gusht; projektligji për mbrojtjen nga zhurma është shpërndarë më 1 shtator; ndërsa projektligji për pajisjet nën presion është shpërndarë më 6 shtator. Andaj, projektligjet janë shpërndarë 25, 24, përkatësisht 21 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare më 9 tetor.

*Kjo nuk është në pajtim me rregullën 35.1, e cila parasheh që shqyrtimi i parë i projektligjit të bëhet jo më parë se dhjetë ditë pune dhe as më shumë se tri javë pune nga dita e shpërndarjes së tij. Me përjashtim të projektligjit për mbrojtjen e varieteteve të bimëve, të gjithë projektligjet tjera të lartpërmendura e kanë pasur shqyrtimin e parë pasi kanë kaluar tri javë pune nga data e shpërndarjes së tyre. Kuvendi edhe më tej vazhdon të ketë vështirësi në shqyrtimin e projektligjeve në pajtim me afatin e caktuar në Rregulloren e punës, përkundër faktit se ka filluar t'i mbajë seancat plenare më shpesh.*

#### Deklarata për dënimin e incidenteve të sigurisë në Kosovë

- Gjatë seancës plenare të 21 shtatorit, z. Sabri Hamiti (LDK) e lexoi me zë tekstin e deklaratës për dënimin e incidenteve të sigurisë në Kosovë, i dakorduar nga shefat e të gjitha grupeve parlamentare. Teksti i deklaratës është si vijon “(a) Kuvendi i Kosovës dënon me forcë shpërthimet e ditëve të fundit në Gjilan, Ferizaj dhe Klinë duke i konsideruar akte dhune e terrori që rrezikojnë jetën e njerëzve dhe krijojnë pasiguri në vend, (b) Kuvendi i Kosovës kërkon nga SHPK-ja, nga Policia e UNMIK-ut dhe nga përgjegjësit e tjerë të sigurisë në Kosovë, që kryesit e këtyre akteve të dhunës e të terrorit të nxirren para ligjit si dhe të parandalojnë veprimet që rrezikojnë sigurinë e qytetarëve të Kosovës, dhe (c) Kuvendi i Kosovës vlerëson që aktet e dhunës dhe të terrorit prishin pamjen e Kosovës para botës dhe dëmtojnë rëndë politikisht procesin e pavarësimit të Kosovës.” Më pas, Kryetari i Kuvendit e hedhi në votim formal deklaratën, e cila është miratuar me shumicë votash për.

*Kjo është në pajtim me rregullën 2, e cila përcakton se deklaratata është “deklarim i përgjithshëm politik, që votohet dhe miratohet nga Kuvendi.”*

#### Procesi i votimit

- Gjatë seancës plenare më 31 gusht, derisa Kuvendi po përgatitej për ta votuar në parim projektligjin për adaptimin e Konventës së Këshillit të Evropës mbi krimin në fushën e kibernetikës, Kryetari i Kuvendit njoftoi se në sallë ishin të pranishëm 62 deputetë dhe më pas i ftoi ata që ta votonin projektligjin në fjalë, i cili ka marrë 54 vota për, asnjë votë kundër dhe një abstenim. Z. Jakup Krasniqi (PDK) deklaroi se projektligji nuk mund të konsiderohej i miratuar me arsyetimin se së paku 61 deputetë duhet të ishin deklaruar me anë të votimit lidhur me projektligjin në fjalë. Kryetari i Kuvendit konstatoi se gjatë votimit ishin të pranishëm 62 deputetë dhe shtoi se sipas rregullës 31.3, miratimi i projektligjit në fjalë është i vlefshëm. Kishte kuorum për të gjitha votimet në seancat plenare në fjalë.

*Kjo është në pajtim me nenin 9.1.32 të Kornizës Kushtetuese dhe rregullën 31.1, të cilat parashohin se për t'u marrë një vendim nga Kuvendi, duhet të jenë të pranishëm shumica e deputetëve (së paku 61). Për më tepër, rregulla 31.3 parasheh që “ligjet . . . konsiderohen të miratuara kur për to të ketë votuar shumica e deputetëve të pranishëm dhe që votojnë”. Prandaj, miratimi i projektligjit për adaptimin e Konventës së Këshillit të Evropës mbi krimin në fushën e kibernetikës ishte i vlefshëm meqë për të kanë votuar shumica e deputetëve të pranishëm. Raportet e mëhershme të monitorimit kanë dokumentuar disa raste kur numri i votave për, votave kundër dhe abstenimeve rezultonte më i vogël se numri i përgjithshëm i deputetëve të pranishëm gjatë votimit. Kjo ndodh sepse disa deputetë thjesht nuk e ngrisin dorën fare kur Kryetari i Kuvendit i thërret të votojnë për, kundër, apo të abstenojnë.*

## Interpelanca

- Më 16 gusht, PDK-ja i ka parashtruar Kryesisë së Kuvendit një mocion për interpelancë me të cilin kërkonte nga Kryeministri Agim Çeku të shpjegojë letrën të cilën e kishte marrë nga Kryesia e LDK-së. Në këtë mocion, PDK-ja pohonte se “letra e dërguar nga LDK-ja ka krijuar paqartësi dhe dilema lidhur me autoritetin e Kryeministrit mbi Qeverinë. Ftojme Kryeministrin që ta shpjegojë përmbajtjen e letrës që ai ka marrë nga Kryesia e LDK-së dhe deklaratën e tij lidhur me funksionimin e Qeverisë, kur më shumë se gjysma e kabinetit qeveritar është jashtë autoritetit të tij, dhe në çfarë mase kjo letër ka ndikuar në autoritetin e tij dhe në efikasitetin e Qeverisë.”<sup>10</sup> Më 25 gusht, Kryesia pa diskutim është pajtuar që t’ia përcjellë mocionin për interpelancë Qeverisë. Më 4 shtator, Kryeministri i ka dërguar Kryesisë një letër në të cilën pohonte se ishte i gatshëm t’i përgjigjej interpelancës kurdo që të vendosej në rendin e ditës nga Kryesia. Kryesia, në mbledhjen e saj të mbajtur më 11 shtator, e ka caktuar debatin për interpelancën në fjalë për seancën plenare të 21 shtatorit.

Në seancën plenare të 21 shtatorit, Kryetari i Kuvendit ua përkujtoi deputetëve se sipas rregullës së re 25, grupi parlamentar që ka propozuar debatin për interpelancë ka të drejtë ta hapë debatin me një deklaram dhjetë minutësh dhe ta mbyllë atë me një deklaram pesë minutësh, derisa ndarja e kohës së mbetur për debat do të bëhej sipas fuqisë së secilit grup parlamentar në Kuvend. Z. Jakup Krasniqi (PDK) e hapi debatin e interpelancës duke e kritikuar Kryeministrin se nuk i ishte përgjigjur me kohë interpelancës, duke shtuar se “Kryeministri po luan me Kuvendin dhe me publikun”. Z. Krasniqi vazhdoi duke thënë se letra e Kryesisë së LDK-së ishte një sulm kundër organit më të lartë ekzekutiv të Kosovës, dhe se e zvogëlonte fuqinë vendimmarrëse dhe politike të Kryeministrit, si dhe autoritetin e tij në raport me bashkësinë ndërkombëtare. Duke iu drejtuar Kryeministrit, z. Krasniqi vazhdoi duke thënë “pas kësaj letre e cila të privon nga e drejta për ta qeverisur këtë vend, ju duhet seriozisht ta rishqyrtoni pozitën tuaj si Kryeministër dhe mos e lejoni rrënimin e autoritetit tuaj moral që jua ka dhënë UÇK-ja se do të bënit mëkat ndaj një vlere të shenjtë të kombit.” Kryeministri siguroi se ai me kohë ia kishte dërguar një letër Kryesisë në të cilën pohonte se ishte i gatshëm t’i përgjigjej interpelancës. Duke iu referuar letrës së LDK-së, ai deklaroi se autoriteti i tij buronte nga Korniza Kushtetuese dhe Rregullorja e Punës e Qeverisë, duke shtuar se “një letër pa asnjë fuqi ligjore nuk mund t’i ndryshojë apo kufizojë autorizimet e mia”. Disa deputetë nga grupe të ndryshme parlamentare bënë deklaram para se debati të mbyllej nga z. Krasniqi.

*Sipas rregullës së re 25.5-6, “Kryesia e Kuvendit, menjëherë sapo ta ketë marrë tekstin e interpelancës, ia dërgon Qeverisë, e cila është e detyruar ta shqyrtojë brenda shtatë (7) ditësh. Interpelanca vihet në rendin e ditës në afatin prej shtatë (7) ditësh, pasi të merret përgjigja nga Qeveria.” Kryeministri i ka kthyer përgjigjen Kryesisë brenda afatit. Kryesia është takuar një javë pas marrjes së përgjigjes nga Kryeministri dhe e ka caktuar debatin e interpelancës për seancën plenare të 21 shtatorit, e jo për atë të 14 shtatorit, sepse Kryeministri ishte jashtë vendit gjatë atyre ditëve. Sikur Kryesia të ishte mbledhur më herët, debati i interpelancës do të caktohej më parë.*

- Më 13 shtator, grupi parlamentar ORA ka parashtruar një mocion të interpelancës për Ministrin e Shëndetësisë Sadik Idrizi, në të cilin kërkonte nga ai të raportojë para Kuvendit lidhur me “masat që ai është duke i marrur për tejkalimin e gjendjes së vështirë në sistemin shëndetësor.” Kryesia, në mbledhjen e saj të mbajtur më 3 tetor, është pajtuar pa diskutim që t’ia përcjellë mocionin për interpelancë Qeverisë.<sup>11</sup>

<sup>10</sup> Z. Eqrem Kryeziu, në emër të Kryesisë së LDK-së, i ka dërguar një letër Kryeministrit më 6 korrik 2006, në të cilën ai ka deklaruar se “(a) të gjitha pozitat e larta të Ministrive të reja në Qeveri (Ministra, Zëvendësministra), zyrtarët e lartë të agjensioneve, bordeve dhe departamenteve, do t’i takojnë LDK-së, (b) zëvendëskryeministri z. Lutfi Haziri mandatohet që të përcjellë performancën e Ministrave të Qeverisë që përfaqësojnë LDK-në, (c) bordet e agjensioneve rregullative duhet të reformohen me qëllim të shtimit të efikasitetit si dhe rritjes së profesionalizmit, (ç) përfaqësuesit e Kosovës jashtë shtetit duhet të caktohen në konsultim me LDK-në dhe të emërohen nga Presidenti i Kosovës, dhe (d) negociatat për status duhet të udhëhiqen nga LDK-ja në bashkërendim të plotë me AAK-në.”

<sup>11</sup> Debati i interpelancës e kërkuar nga ORA është mbajtur jashtë periudhës raportuese dhe do të mbulohet nga raporti i radhës.



*Kjo është në pajtim me rregullën e re 25.1 dhe 25.5.*

#### Pyetjet për Qeverinë

- Në seancën plenare të 31 gushtit, gjashtë nga tetë pyetje kanë marrë përgjigje. Znj. Zylfije Hundozi (AAK) bëri vërejtjen që pyetja e saj për Ministrin për Ekonomi dhe Financa e përsëritur nga seanca e fundit përsëri nuk kishte marrë përgjigje në seancën në fjalë, dhe propozoi që Kuvendi t'i bëjë vërejtje ministrit për faktin që nuk ishte i pranishëm në seancë për t'iu përgjigjur pyetjes së saj. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se pyetjet që nuk kanë marrë përgjigje në dy seanca plenare do të publikohen në buletinin e Kuvendit. Në seancat plenare të 31 gushtit dhe 9-10 tetorit, z. Hydajet Hyseni (PDK) e shtroi përsëri çështjen e pyetjes që ia kishte parashtruar Ministrin për Pushtetin Lokal, para një kohe të gjatë, e që ende nuk kishte marrë përgjigje, dhe këmbënguli që të merrte përgjigje. Kryetari i Kuvendit nuk e komentoi vërejtjen e z. Hyseni.

*Periodha e pyetjeve është kryer në pajtim me rregullën e re 26 mbi “Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë”.*

*Z. Hyseni së pari e kishte dorëzuar pyetjen e tij më 8 gusht 2005, kur rregulla e mëparshme 26 mbi pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë ishte në fuqi.<sup>12</sup> Më 13 qershor, pas ndryshimit të rregullës 26 në seancën plenare të 1-2 qershorit 2006, z. Hyseni e ka parashtruar pyetjen e tij përsëri, e cila ishte caktuar për seancën plenare të 15 qershorit, por nuk kishte marrë përgjigje. Sipas rregullës së re 26.11, “nëse pyetja nuk ka marrë përgjigje brenda dy seancave ajo publikohet në Buletinin e Kuvendit për një periudhë prej dymbëdhjetë (12) muajve.” Kanë kaluar gjashtë seanca plenare nga koha kur z. Hyseni e ka përsëritur pyetjen e tij, dhe nuk ka marrë përgjigje. Poashtu, buletini i Kuvendit të Kosovës nuk përmban pyetjet që i janë parashtruar Qeverisë, kështu që pyetjet që nuk kanë marrë përgjigje nuk janë publikuar asnjëherë.*

#### **4. Qasja dhe pjesëmarrja e barabartë e komuniteteve**

- Në seancën plenare të 1 shtatorit, gjatë debatit për procesin e zgjidhjes së statusit, z. Xhezair Murati (6+/Vakat) ka bërë vërejtjen se materiali që u ishte shpërndarë deputetëve ishte vetëm në gjuhën shqipe, duke komentuar se “është e drejtë e jona fundamentale t'i kemi dokumentet në gjuhën tonë, që të mund të marrim pjesë në debat në mënyrë të barabartë.” Debati është ndërprerë atë ditë dhe ka vazhduar më 6 shtator, me ç'rast materiali është përkthyer në të dy gjuhët zyrtare.

*Rregulla 55 parasheh që “të gjitha dokumentet zyrtare të Kuvendit shkruhen në gjuhën standarde shqipe dhe në gjuhën serbe.” “Dokumentet zyrtare” definohe në rregullën 2, ndër të tjera, si “material i dorëzuar për shqyrtim nga Kuvendi ose ndonjëri nga komisionet e tij”. Andaj, vendosja e një pike në rend dite për të cilën materialet e nevojshme nuk janë shpërndarë në dy gjuhët zyrtare të Kuvendit, nuk është në pajtim me rregullën 55. Kjo poashtu ka rezultuar me shkeljen e rregullës 12, e cila thotë se “deputetët e Kuvendit kanë të drejtë dhe detyrë të barabartë për pjesëmarrje të plotë në punimet e Kuvendit . . . [përfshirë të drejtën] për të marrë pjesë në kushte të barabarta me deputetët e tjerë të Kuvendit në të gjitha diskutimet,” ngase më 1 shtator deputetët boshnjakë dhe serbë nuk ishin në gjendje të marrin pjesë në mënyrë të barabartë me deputetët tjerë në debat.*

#### Mocionet kundër ligjeve të miratuara mbi bazën e ndikimit të tyre në interesat jetike të komuniteteve

- Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 25 gusht, e ka diskutuar përgjigjen e Qeverisë në mocionin e grupi 6+ kundër Ligjit për përdorimin e gjuhëve.<sup>13</sup> Në përgjigjen e saj, Qeveria i

<sup>12</sup> Shiko raportet 03/2006 dhe 05/2006 të Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës, përkatësisht paragrafin e titulluar “Pyetjet për Qeverinë.”

<sup>13</sup> Për më shumë detaje, shiko raportin 05/2006 të Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

ka rekomanduar Kryesisë që ta mbështesë mocionin e grupit 6+. Kryetari i Kuvendit gjithashtu e ka inkurajuar Kryesinë që ta mbështesë mocionin në vend se të propozojë formimin e Panelit Special për t'u marrë me këtë çështje, gjë që do të shtyente miratimin e ligjit. Pas një diskutimi të konsiderueshëm, Kryesia nuk mund të arrinte konsensus lidhur me mocionin, kështu që propozoi formimin e Panelit Special për t'u marrë me këtë çështje.

Në seancën plenare të 14 shtatorit, Kuvendi ka shqyrtuar rekomandimin e Panelit Special lidhur me mocionin në fjalë. Z. Alush Gashi (LDK) deklaroi se grupi i tij nuk do të votonte në favor të rekomandimit të Panelit, ndërsa z. Jakup Krasniqi (PDK), znj. Gjylnaze Sylja (AAK), z. Nazim Jashari (ORA) dhe z. Ferid Agani (Për Integrim) e mbështetën rekomandimin. Andaj, Kryetari i Kuvendit e hudhi në votim rekomandimin, i cili është hedhur poshtë me 41 vota për dhe 48 vota kundër.

Gjatë seancës plenare të 21 shtatorit, Kryetari i Kuvendit konstatoi se hedhja poshtë e rekomandimit të Panelit në seancën e kaluar "i ka zhgënjyer miqtë tanë ndërkombëtarë dhe ishte kthim mbrapa në përmbushjen e standardeve." Ai tha se Ligji në fjalë ishte një nga prioritetet e Grupit të Kontaktit për Kosovën, prandaj e inkurajoi Kuvendin që ta miratonte rekomandimin e Panelit. Ai më pas e ftoi Kuvendin që me një votim të vetëm ta shfuqizonte vendim e mëparshëm dhe ta miratonte rekomandimin e Panelit. Rekomandimi i Panelit është miratuar me 59 vota për dhe shtatë vota kundër.

- Kryesia, në takimin e mbajtur më 25 gusht, ka shqyrtuar përgjigjen e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në mocionin e Grupit për Integrim me të cilin kundërshtojë Ligji për ndërprerjen e shtatzënisë,<sup>14</sup> dhe ka propozuar formimin e Panelit Special për t'u marrë me këtë çështje. Paneli Special ende nuk është formuar.

*Sipas nenit 9.1.41 të Kornizës Kushtetuese dhe rregullës 40.3, "nëse Kryesia nuk arrin ta paraqesë propozimin konsensual brenda pesë ditësh, këtë çështje automatikisht e merr përsipër një Panel Special tre anëtarësh i përbërë nga një përfaqësues të propozuesve dhe të kundërshtuesve dhe një anëtar që do ta kryesonte Panelin, i caktuar nga PSSP-ja. Paneli merr vendim brenda pesë ditësh dhe i rekomandon Kuvendit që ta hedhë poshtë mocionin . . . apo dispozitën në fjalë, ose që Kuvendi ta miratojë ligjin me ndryshimet e propozuara nga Paneli." Paneli Special duhet prandaj të formohet sa më parë që ta trajtojë mocionin e Grupit për Integrim.*

## 5. Qasja

Gjatë periudhës raportuese, Shtylla e III-të (OSBE) ka pasur qasje në seancat plenare, në mbledhjet e Kryesisë, si dhe në të gjitha komisionet. Shtylla e III-të (OSBE) gjithashtu ka pranuar kopjet e dokumentave të shqyrtuara nga Kuvendi si dhe transkriptet e seancave të kaluara.

## 6. Transparenca

Radio Televizioni i Kosovës (RTK) ka siguruar transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave plenare në fjalë. Më 6 shtator, seanca plenare ka zgjatur më shumë, duke përfshirë kohën e planifikuar për program të rregullt të RTK-së. Andaj, pjesa e fundit e seancës plenare nuk është transmetuar drejtpërdrejtë, por më vonë atë mbrëmje.

Publikut dhe monitoruesve institucional iu është mundësuar hyrja në seancat plenare. Kuvendi ka web-faqen ([www.kuvendikosoves.org](http://www.kuvendikosoves.org), [www.skupstinakosova.org](http://www.skupstinakosova.org), [www.assemblyofkosovo.org](http://www.assemblyofkosovo.org)). që përmban detaje biografike të deputetëve të Kuvendit, informata për strukturën dhe funksionimin e Kuvendit, kopje të ligjeve dhe rezolutave të miratuara nga Kuvendi, si dhe informata tjera në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

FUND.

<sup>14</sup> Për më shumë detaje, shiko raportin 05/2006 të Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.